



**PROGRAM ORIENTUES
PËR TESTIMIN E INFORMATIZUAR
“MËSUES PËR SHQIPËRINË”
2024**

**PËR
SHKENCAT SOCIALE**

LËNDËT: FILOZOFI, PSIKOLOGJI, SOCIOLOGJI, EKONOMI DHE QYTETARI



TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES.....	1
HYRJE.....	2
QËLLIMI I PROGRAMIT.....	3
PËRMBAJTJA E PROGRAMIT.....	4
FUSHA: DOKUMENTE ZYRTARE.....	4
FUSHA: PROGRAME LËNDORE.....	6
FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK- UT NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE.....	7
FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT.....	10
FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE.....	10
FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS.....	11



HYRJE

Programi orientues për testimin e kandidatëve të shkencave sociale është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) për t’u ardhur në ndihmë të gjitha Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave të Arsimit të rretheve, si dhe të gjithë kandidatëve për t’u përgatitur për testim.

Programi është zhvilluar duke iu përgjigjur kërkesave që MAS-i ka vendosur për kandidatët që testohen. Programi është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve janë:

- Dokumente zyrtare¹ të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë mësimore dhe edukative të mësuesve.
- Programe të lëndëve shoqërore.
- Aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë në mësimdhënie-nxënie.
- Aspekte të etikës dhe të komunikimit.
- Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- Përmbajtja shkencore e lëndës, sipas programeve të lëndëve shoqërore.

¹ Është fjala për të gjitha dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MAS-it që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.



QËLLIMI I PROGRAMIT

Programi orientues për testimin e kandidatëve të shkencave sociale është hartuar për të mbështetur dhe për të nxitur zhvillimin profesional të tyre. Programi është hartuar nga grupi i punës duke mbajtur parasysh përmbushjen e dy qëllimeve kryesore:

- *Së pari*, të ofrohet si një program orientues për t'u ardhur në ndihmë Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave të Arsimit, si dhe të gjithë mësuesve të lëndëve të shkencavesociale të arsimit parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese në bazë rrethi. Në këtë aspekt programi mund të plotësohet nga DAR/ZA-të përkatëse, sipas kushteve dhe mundësive konkrete.
- *Së dyti*, të ofrohet si një program i detyruar, veçanërisht për kandidatët, për të përballuar me sukses kërkesat që ka testimi.

Programi synon:

- rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit arsimor e në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformës arsimore;
- rritjen e aftësive dhe kompetencave profesionale të kuadrit mësimdhënës, për të ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e efektivitetit të procesit mësimor drejt një mësimdhënieje të suksesshme;
- rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për domosdoshmërinë e njohjes së koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për njohjen dhe zbatimin e rregullave të etikës dhe të komunikimit në punën e tyre në shkollë;
- rritjen e aftësive të mësuesve në drejtim të zbatimit me saktësi të rregullave drejtshkrimore të shqipes;
- realizimin në praktikë, nëpërmjet demonstrimit konkret të aftësive të fituara dhe, në mënyrë të veçantë, nëpërmjet vlerësimit të arritjeve përmes testimit.



PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi orientues për testimin e kandidatëve të shkencave sociale është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional të përmendura më sipër. Për secilën fushë janë renditur njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojë mësuesi i lëndës së shkencave sociale që të përmbushë me sukses rubrikat e testimit.

Programi është ndërtuar duke pasur si pikënisje standardet bazë të përgjithshme të mësuesit si dhe standardet e mësuesit të shkencave sociale. Përshkallëzimi i kompetencave profesionale që lidhet me secilën fushë të testimit do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë nevojat e tij, si dhe çështjet në të cilat duhet të thellohet më shumë.

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Sipas këtij formati, për secilën fushë prezantohen kompetencat që mësuesit duhet të zotërojnë në fushën e njohurive dhe aftësive, si dhe literatura përkatëse rekomanduese që u vjen në ndihmë për zotërimin e këtyre kompetencave.

FUSHA: DOKUMENTEZYRTARE

Kompetenca “Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe të dokumentacionit shkollor”	Literatura e rekomanduar
Mësuesi: <ul style="list-style-type: none">- përshkruan dokumentacionin shkollor të nevojshëm për mbarëvajtjen e procesit mësimor-edukativ në të gjitha hallkat e tij;- vlerëson risitë e dokumentacionit që po shqyrton;	<ul style="list-style-type: none">- Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.- Urdhër Nr. 31 datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”.

<ul style="list-style-type: none"> - zberthen përgjegjësitë e tij në zbatim të kërkesave të dokumentacionit shkollor; - Lidh kërkesat e dokumentacionit shkollor me punën e tij në klasë dhe në shkollë dhe me ato që lidhen me zhvillimin e tij personal, kualifikimin. 	<ul style="list-style-type: none"> - Udhëzimi nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar” i ndryshuar. - Udhëzimi nr. 2, datë 08.02.2023. “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”. -Udhëzimi nr. 17, datë 05.07.2022 “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”. - Udhëzimi nr. 16, datë 28.07.2021 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë” - Urdhër Nr.6, datë 10.01.2018 për zbatimin e nismës “Tri lëndë në gjashtë orë”. - Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”.
--	--

FUSHA: PROGRAME LËNDORE

Kompetenca “Zbatimi në mënyrë efektive i programeve të lëndëve shoqërore në shkollë”	Literatura e rekomanduar
<p>Mësuesi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përcakton çfarë nxënësit duhet të dinë dhe të jenë të aftë të bëjnë në zbatim të programit lëndor; - analizon karakterin konkret dhe të qartë të përmbajtjes së kurrikulës; - vlerëson zbatimin cilësor të programit; - propozon rishikimin e programit lëndor: kërkesat ndaj mësuesit si nismëtar i ndryshimit ose i përmirësimit të programit lëndor. - ndërton situatën e të mësuarit për çdo mësim në përputhje me rezultatet e pritshme të programit dhe të kërkesave të kornizës kurrikulare për vlerësimin e nxënësve. <p>Mësuesi thëllon të kuptuarit rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lidhjeve mes njohurive të lëndës që jep mësim me njohuritë e disiplinave të tjera që zhvillohen në shkollë; - vlerësimin të këndvështrimeve të ndryshme që shfaqin nxënësit gjatë mësimit. 	<ul style="list-style-type: none"> - Korniza Kurrikulare 2014. - Kurrikula bërthamë AMU, klasat VI-IX, 2014. - Kurrikula bërthamë AML, klasat X-XII, 2016. - Programet e reja (2015, 2016, 2017), të bazuara në kompetenca për klasat 6,7,8,9 të arsimit të mesëm të ulët si dhe për klasën e 10-të dhe 11-të të arsimit të mesëm të lartë.

FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK-UT NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE

Kompetenca I	Literatura e rekomanduar
“Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien e shkencave shoqërore”	
<p>Mësuesi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zhvillon mësimdhënie në përshtatje me synimet dhe objektivat konkrete të lëndës që jep; - zhvillon koncepte dhe metoda që e bëjnë nxënësin të aftë për të zbatuar njohuritë e reja. - dallon pyetjet e hapura dhe të mbyllura, të strukturuar dhe gjysmë të strukturuar. <p>Mësuesi thellon të kuptuarit rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> - hartimit të rezultateve të të nxënit; - teknikave të të pyeturit; - përgatitjes së planit ditor; - nxënësve të vështirë dhe punës së diferencuar; - mësimdhënies alternative, nëpërmjet mësimëve të organizuara mirë për çdo sekuencë, duke përdorur strategjitë e përshtatshme, metodat zhvilluese, teknologjitë e të nxënit, si dhe duke kombinuar punën individuale me punën në grup; - zotërimin të kërkesave për vlerësimin e 	<ul style="list-style-type: none"> • Literaturë që ka në fokus metodat e mësimdhënies ndërvepruese, me në qendër nxënësin. • Udhëzues dhe materiale mbështetëse që orientojnë për përgatitjen e ditarit të mësuesit, për organizimin e orës së mësimin etj.. • Situatat e të nxënit, IZHA, 2015. • Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015. • Literaturë që ka në fokus aspekte pedagogjike të punës së mësuesit me nxënësit e tij. • Udhëzuesi i gjimnazit, 2016. • Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017 • Udhëzues për kurrikulën me zgjedhje në gjimnaz, IZHA 2018. • Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), 2016.

<p>arritjeve të nxënësve, në zbatim të parimeve të vlerësimit të shpallura në “Kornizën Kurrikulare të arsimit parauniversitar”, duke përdorur teknikat dhe instrumentet e diagnostikimit dhe të vlerësimit, si dhe u siguron nxënësve dhe prindërve informacionet e nevojshme në kohën e duhur.</p>	
<p style="text-align: center;">Kompetenca II</p> <p style="text-align: center;">“Përdorimi i metodave dhe i strategjive efektive në mësimdhënien e shkencave shoqërore”</p>	<p style="text-align: center;">Literatura e rekomanduar</p>
<p>Mësuesi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e rezultateve të të nxënët; - përdor metoda e teknika që nxisin mendimin e pavarur e krijues të nxënësve; - planifikon një orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin; - përdor metoda e teknika që nxisin zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve; - përdor metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen; - zhvillon kompetencat për kulturë demokratike përmes të mësuarit në fushën e shkencave shoqërore; - demonstroi teknika të ndryshme për vlerësimin e nxënësit; 	<ul style="list-style-type: none"> - Të nxënët me situata, kompetenca dhe situata e të nxënët, IZHA, 2014. - Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015. - Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017 - Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në gjimnaz 2016. - Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), IZHA, 2016. - Portofoli i të nxënët, IZHA, 2015. - Vlerësimi i nxënësit në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë. (<i>Material shpjegues në ndihmë të shkollave</i>), shtator 2019. -

<ul style="list-style-type: none"> - shpjegon parimet e hartimit të një testi. 	
<p style="text-align: center;">Kompetenca III</p> <p style="text-align: center;">“Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies në shkencat shoqërore”</p>	<p style="text-align: center;">Literatura e rekomanduar</p>
<p>Mësuesi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - prezanton materiale të shkencave shoqërore duke përdorur teknologji të përshtatshme si: PowerPoint, Excel, Word; - nxit nxënësit të bëjnë prezantime duke përdorur programe kompjuterike të njohura për ta; - gjen dhe përdor materiale nga uebsite për të pasuruar dhe perfeksionuar mësimdhënie-nxënien; - përfshin nxënësit në projekte kurrikulare të lëndëve shoqërore ose në projekte kurrikulare të integruara të cilat ndërthuren me kërkime, gjetje dhe përdorime materiale nga uebsite. 	<ul style="list-style-type: none"> - Tekste nxënësi apo materiale në ndihmë të mësuesit të lëndëve shoqërore që përdoren në klasat 6,7,8,9 të arsimit të mesëm të ulët si dhe në klasat 10,11,12 të arsimit të mesëm të lartë dhe kanë në fokus përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie - nxënie.

FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT

Kompetenca “Zbatimi i rregullave të etikës dhe të komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit”	Literatura e rekomanduar
<p>Mësuesi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shpjegon lidhjen ndërmjet parimeve të Kodit të Etikës me cilësinë e shërbimit që duhet të ofrohet në shkollë; - merr vendime në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor; - merr vendime që ndihmojnë në zbatimin e parimeve të etikës në procesin e mësimdhënies dhe të mësuarit. 	<ul style="list-style-type: none"> - Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar. - Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”.

FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe	Literatura e rekomanduar
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p>Mësuesi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njeh rregullat e drejtshkrimit të standardit të gjuhës shqipe; - zbaton rregullat e drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor. 	<ul style="list-style-type: none"> - Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.

FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS

<p style="text-align: center;">Kompetenca</p> <p style="text-align: center;">“Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien e shkencave shoqërore”</p>	<p style="text-align: center;">Literatura e rekomanduar</p>
<p>Mësuesi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - bën që nxënësit të përshkruajnë, të analizojnë, të vlerësojnë, të diskutojnë, të mbajnë qëndrim; - dallon çfarë studiojnë lëndët e shkencave shoqërore; - u jep mundësi nxënësve të njohin dhe të përshkruajnë dukuri, ngjarje, ide, këndvështrime që drejtpërdrejt ose tërthorazi lidhen me vendin tonë; - drejton nxënësit në përdorimin e proceseve të të menduarit, të analizuarit e dukurive etj.; - mbështet nxënësit në kuptimin dhe përdorimin e koncepteve, teorive dhe parimeve që lidhen me lëndët e shkencave shoqërore; - bën që nxënësit të marrin parasysh se si faktorë të tillë si kriza, papunësia, inflacioni, buxheti, tregtia ndërkombëtare, prodhimi, kostoja etj., ndikojnë në veprimet dhe vendimet e njerëzve në momente të caktuara. 	<ul style="list-style-type: none"> - Programet dhe tekste të shkencave shoqërore për nxënësin dhe për mësuesin. - Literaturë shkencore dhe burimore për përmbajtjen e lëndës për klasat 6-12 të arsimit parauniversitar

**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**



Rruga "Naim Frashëri"
Nr. 37
Tiranë
Shqipëri

(+355) 4256440 / 4256441

sekretaria@ascap.edu.al

www.ascap.edu.al